



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 datës 4 Qershor 2008, nenit 9 shkronja (h), 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Shkresën përcjellëse 02.1624-2/26 datë 28.04.2026 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit 15Nr.353/01-15238 dhe Shkresës sqaruese të dërguar përmes emailit zyrtar të datës 04.05.2026, në mbledhjen e mbajtur me datë ____ 2026 të miratohet kështu:

PROPOZIM

VENDIM

NDRYSHIMIN E TITULLARIT TË PALUAJTSHMERISË NGA SHKOLLA BUJQËSORE NË SHKOLLËN E MESME GJIMNAZI "ULPIANA" NË LIPJAN

Neni 1

NDRYSHOHET emërtimi i titullarit të paluajtshmërive në njësitë kadastrale P-71409044-00846-12 në vendin e quajtur "Bezimeni" me sipërfaqe prej 8113m² dhe njësisë kadastrale P-71409044-00846-13 me sipërfaqe prej 6128m² e evidentuar në certifikatën e pronësisë Nr.55-2026 në ZK-Lipjan, nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan

Neni 2

Ndryshimi i titullarit ashtu siç u cek në nenin 1 të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të ristrukturimit të shkollave të qytetit të Lipjanit dhe bartjes së pronësisë të njësisve kadastrale me sipërfaqet e lartëcekura nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan, si pjesë e interesit publik.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjinnazi "Ulpiana" në Lipjan, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektorit pronëso-ro-juridik, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen elektronike të Komunës.

A r s y e t i m

Drejtoria Komunale e Arsimit-Lipjan me datë 27.02.2026 ka parashtruar kërkesën 1Nr-462/01-10342 pran Zyrës së Kryetarit-Sektorit pronëso-ro-juridik, përmes së cilës ka kërkuar hartimin e Propozim-Vendimit për Kuvendin Komunal-Lipjan, duke marr për bazë konsideraten e sistemimit të shkollave në qytetin e Lipjanit, përkatësisht ndryshimin e titullarit për bartjen e pronësisë me sipërfaqe prej 8113m² nga njësia kadastrale P-71409044-00846-12 në vendin e quajtur "Bezimeni" dhe sipërfaqja prej 6128m² nga njësia kadastrale P-71409044-00846-13 e evidentuar në Certifikatën Nr.55-2026 në ZK-Lipjan, P.SH Shkolla Bujqësore në Lipjan për Shkollën e Mesme Gjinnazi "Ulpiana" në Lipjan, pjesë e interesit publik për ristrukturimin e shkollave në fushën e edukimit arsimor të drejtimit të caktuar.

Duke u bazuar në informacionin urban 8Nr.351/01-19709 datë 04.05.2026 nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, njësitë kadastrale të lartëcekura janë të destinuara si Shërbim Arsimor përkatësisht Shërbime Komuniteti, sipas Hartes Zonale të Komunës konform Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.30033 datë 03.06.2021.

Ky Propozim-Vendim është miratuar paraprakisht në Kuvendin e Komunës, mirëpo me Shkresën përcjellëse 02-1624-2/26 datë 28.04.2026 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është kërkuar rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të lartëcekur duke kërkuar që i njëjti të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës.

Përkitazi me këtë shkresë, Zyra ligjore përmesë emalit zyrtar ka dërguar një informatë sqaruese me datë 29.04.2026 dhe pastaj kemi pranuar Shkresën sqaruese të MMPH-së përmes emalit zyrtar me datë 04.05.2026, ku përfundimisht është kërkuar që të bëhet harmonizimi i titullit të vendimit me përmbajtjen e tij.

Prandaj duke u bazuar në dispozitat ligjore, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për arsim dhe edukim më të avancuar dhe interesit publik, konform edhe rekomandimeve të MMPH-së kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij Propozim-Vendimi

Shtojcë:

- Certifikata e pronësisë Nr.55 datë 27.02.2026 për parcelat 00846-12 dhe 00846-13 në ZK-Lipjan
- Kopjet e planit për parcelat 00846-12 dhe 00846-13 në ZK-Lipjan,
- Shkresa e MMPH-së, me numër të protokollit 02-1624-2/26 datë 28.04.2026,
- Informata sqaruese nga Zyra Ligjore, përmesë emailit zyrtar datë 29.04.2026 dhe
- Shkresa sqaruese nga MMPH-së, përmesë emailit zyrtar datë 04.05.2026.

1Nr. 01 - 462/01 - 27324

Datë: 18.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës
Republica Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKTI NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : P.SH. SHKOLLA BUJQËSORE LIPJAN


Nomri i lënës / Broj Predmet / Case Reference/Number: 55-2026n
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vrenje izdavanja / Date and time of submission: 27.02.2026 - 10:04
Komuna / Opština / Municipality: LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN
Zyra Kadastrale Komunele / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i atarizantit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babat Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Licni broj/broj postovanja ID No.	Shteti i shtetësisë apo regjistruarit Drzava državljanstva ili državljenja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krituar më datën Urdieno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P.SH. SHKOLLA BUJQËSORE LIPJAN			/	KCIDB1417382	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS


Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN			LIPJAN	



B. NIESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT



Niesia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type	Kati/ Katet Br-Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i qajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktuelna ipotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-71409044-00846-11	LIPJAN/ LIPJAN/ LIPJAN	Lipjan/ Lipjan/ Lyipjan	PARCELË/ PARCELA/ parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /U		BEZIMENI/ BEZIMENI/ BEZIMENI	65849	Tokë Ndërtimore - Oborr - (65849 m ²) Gradjevinisko zemljište - Dvoršite - / / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavna / Single possessor	27.02.2026
P-71409044-00846-12	LIPJAN/ LIPJAN/ LIPJAN	Lipjan/ Lipjan/ Lyipjan	PARCELË/ PARCELA/ parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /U		BEZIMENI/ BEZIMENI/ BEZIMENI	8113	Tokë Ndërtimore - Oborr - (8113 m ²) Gradjevinisko zemljište - Dvoršite - / / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavna / Single possessor	27.02.2026
P-71409044-00846-13	LIPJAN/ LIPJAN/ LIPJAN	Lipjan/ Lipjan/ Lyipjan	PARCELË/ PARCELA/ parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /U		BEZIMENI/ BEZIMENI/ BEZIMENI	6128	Tokë Ndërtimore - Oborr - (6128 m ²) Gradjevinisko zemljište - Dvoršite - / / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavna / Single possessor	27.02.2026
P-71409044-00846-14	LIPJAN/ LIPJAN/ LIPJAN	Lipjan/ Lipjan/ Lyipjan	PARCELË/ PARCELA/ parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /U		BEZIMENI/ BEZIMENI/ BEZIMENI	9798	Tokë Ndërtimore - Oborr - (9798 m ²) Gradjevinisko zemljište - Dvoršite - / / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavna / Single possessor	27.02.2026
Totali i sipërfaqes së parcelave:							89888				





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lipjan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71409044-00846-14	Parcelë / Parcela / Parcel	9798
P-71409044-00846-13	Parcelë / Parcela / Parcel	6128
P-71409044-00846-11	Parcelë / Parcela / Parcel	65849
P-71409044-00846-12	Parcelë / Parcela / Parcel	8113



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3647

Punoi/Obradio/Created: Ilir Shala

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 27.02.2026

Koha/ Vreme/ Time: 10:16:28





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Hjësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	OC
Nr. Prot. Brog. Prot. Prot. No.	1624-2/26
Nr. i faqes Broj stranica No. pages	02
Data Datum Date	28.04.2026
PRISHTINE/IA	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data Datum Date	28.04.2026	
Hjësia organizative	Nr. i Lendës	Vlera
-U-	020-248/12	

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në VL 68/26 MMPH Data: 24.04.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim Nr.15-353/01-15238 për caktimin e lokacionit për shkollën e mesme gjimnazi "ULPIANA" në Lipjan, miratuar nga Kuvendi I Komunës së Lipjanit.

I nderuar kryetar Ahmeti,
I nderuar kryesues Azemi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 02.04.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin Nr.15-353/01-15238 për caktimin e lokacionit për shkollën e mesme gjimnazi "ULPIANA" në Lipjan, miratuar nga Kuvendi I Komunës së Lipjanit.

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Lipjanit:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimit Nr.15-353/01-15238 për caktimin e lokacionit për shkollën e mesme gjimnazi "ULPIANA" në Lipjan, miratuar nga Kuvendi I Komunës së Lipjanit.

ARSYETIMI

MMPH, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë dhe në pajtim me nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka konstatuar se:

- Në preambullë nuk është thirrur në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor
- Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor të gjitha planifikimet në kuadër të komunave duhet të jenë sipas Dokumentit të Planifikimit Hapësinor të miratuar nga Kuvendi i Komunës.
- Nuk lejohet destinim apo shfrytëzueshmeri tjetër nga ajo që është e paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor (pjesën tekstuale dhe pjesën grafike)

Në këtë drejtim, theksohet se vendimi duhet të përmbajë referencë të qartë ndaj bazës ligjore dhe dokumenteve përkatëse të planifikimit hapësinor.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave.



RE: Informatë sqaruese

Arta F Krasniqi

Mon 5/4/2026 12:05 PM

To: Vlora R. Krasniqi <vlora.r.krasniqi@rks-gov.net>;

Cc: Imri Ahmeti <Imri.Ahmeti@rks-gov.net>; Daut Azemi <daut.azemi@rks-gov.net>; Rasim Hasani <rasim.hasani@rks-gov.net>; Gafurr Hetemi <gafurr.hetemi@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>; Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Donjeta Cakolli <donjeta.cakolli@rks-gov.net>;

E nderuar znj. Krasniqi,

Ju njoftojmë se pas shqyrtimit të sqarimeve të ofruara nga ana juaj, vlerësojmë se ekziston mospërputhje thelbësore ndërmjet titullit të Vendimit Nr. 15-353/01-15238 dhe përmbajtjes së Vendimit.

Konkretisht, Vendimi në fjalë është i titulluar si "*Vendim për caktimin e lokacionit për Shkollën e Mesme Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan*" që nënkupton çështje të planifikimit hapësinor dhe përcaktimit të lokacionit. Ndërkaq, nga përmbajtja e dispozitivit rezulton se bëhet ristrukturimi i shkollave të qytetit dhe bartjes së pronësisë të njesive kadastrale si pjesë e interes publik.

Për shkak të kësaj mospërputhje, vlerësimi i ligjshmërisë VL 68/26 me nr. Prot. 1624-2/26 i dt. 28.04.2026, lëshuar nga MMPH, mbetet në fuqi.

Rrjedhimisht, ju rekomandojmë që gjatë rishqyrtimit të Vendimit në fjalë, të reflektohet saktë natyra juridike e çështjes që trajtohet.

Me respekt,
Arta Krasniqi.

From: Vlora R. Krasniqi

Sent: Wednesday, April 29, 2026 1:52 PM

To: Arta F Krasniqi <arta.f.krasniqi@rks-gov.net>

Cc: Imri Ahmeti <Imri.Ahmeti@rks-gov.net>; Daut Azemi <daut.azemi@rks-gov.net>; Rasim Hasani <rasim.hasani@rks-gov.net>; Gafurr Hetemi <gafurr.hetemi@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>; Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Donjeta Cakolli <donjeta.cakolli@rks-gov.net>

Subject: Informatë sqaruese

Të nderuar ,

Me datë 28.06.2026, kemi pranuar Shkresën tuaj përcjellëse nr.1624-2/26 të datës 28.04.2026 për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit - Vendimit Nr.15-353/01-15238 për caktimin e lokacionit për shkollën e mesme gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit me datë 31.03.2026 në të cilën keni kërkuar rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit përkatësisht keni kërkuar që në preambulë të përfshihen dispozitat e Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe dokumentet e planifikimit hapësinor të miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Me qëllim të qartësimit të dispozitave të Vendimit të lartëcekur të Kuvendit të Komunës pasi edhe gjatë komunikimit telefonik kemi vërejtur që ka pasur paqartësi nga ana e juaj, **Ju sqarojmë se nuk kemi të bëjmë me ndërtimin e objektit shkollor as ndërrim të destinimit të pronës sepse ajo pronë është komunale dhe aktualisht është pronë e shkollës bujqësore, por kemi kërkuar vetëm që një pjesë nga prona komunale (PSh Shkolla Bujqësore Lipjan) e evidentuar në vendimin e cekur më lartë të kaloj në pronësi të Gjimnazit "Ulpiana" në Lipjan, pra ndërrohet titullari dhe jo destinimi konkretisht një pjesë e pronës komunale e evidentuar në emër të P.SH. Shkolla Bujqësore në Lipjan e cila me harta zonale është e destinuar për Objekte Arsimore, duhet të kaloj në emër të Gjimnazit " Ulpiana" në Lipjan.**

Ky vendim nuk ka asnjë impakt në hartë zonale apo në ndonjë dokument të planifikimit hapësinor të miratuar nga Kuvendi i Komunës prandaj nuk kemi pasur bazë ligjore për tu thirrur në dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe as në dokumentet e planifikimit e planifikimit hapësinor të Komunës të miratuara në Kuvendin Komunal.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga ana e juaj që të anuloni Shkresën tuaj përcjellëse nr.1624-2/26 të datës 28.04.2026 për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit ndërsa Vendimin Nr.15-353/01-15238 për caktimin e lokacionit për Shkollën e mesme Gjimnazi "Ulpiana" ta vlerësoni të ligjshëm brenda një afati sa më të shkurtër në mënyrë që mos të mbetet pezull zbatimi i Vendimit .

Me Respekt, Vlora Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore

Komuna Lipjan

038-200-41506



REPublika e Kosovës REPublika KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENË DANA:		27.02.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT SR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRLOG
01	462/01	10342	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATË /A:	27.02.2026
REFERENCË:	
PËR :	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan Zyra Pronësoro Juridike
NGA:	Rasim Hasani, Drejtor i DKA-së në Lipjan
LËNDA :	Kërkesë për bartje të pronësisë nga Shkollë Bujqësore në Gjymnazin "Ulpiana" në Lipjan



Të nderuar

Duke marr në konsideratë risistemimin e shkollave të qytetit të Lipjanit, kërkojmë nga ju që të merren veprimet e nevojshme për procedurat e bartjes së pronësisë nga shkolla bujqësore në Gjymnazin Ulpiana. Konkretisht parcelat e ndara 00846-12 dhe 00846-13 përmes procedurave të rregullta të kuvendit duhet të kalojnë në pronësi të Gjymnazit Ulpiana.

Shtojcë:

- Kopja e planit
- Fleta Poseduese
- Aktvendimi

Falemnderit në bashkëpunim!